

Deklaratë për Shtyp



BANKA E SHQIPËRISË

1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

DATA	Injektivim likuiditeti			Tërheqje likuiditeti
	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore	REPO njëjavore
02.07.2007			2,000.00	
05.07.2007	0.00			
12.07.2007	0.00			
16.07.2007		3,000.00		
19.07.2007	1,830.00			
26.07.2007	1,150.00			
30.07.2007			3,000.00	
02.08.2007	1,120.00			
07.08.2007		2,880.00		
09.08.2007	1,300.00			
16.08.2007	2,600.00			
23.08.2007	2,770.00			
30.08.2007	260.00			
06.09.2007				210.00
13.09.2007	0.00			
20.09.2007	260.00			
27.09.2007	2,000.00			

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2007 përfshinë operacione të tregut të hapur, kryesisht për injektimin e likuiditetit, në funksion të situatës së tij në sistemin bankar.

Për të injektuar likuiditet, Banka e Shqipërisë ka përdorur pothuaj gjatë gjithë periudhës *marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes, me maturim njëjavor*. Nëpërmjet saj janë injektuar mesatarisht 1.1 miliardë lekë në javë.

Duke parashikuar që mungesa e likuiditetit do të zgjaste gjatë gjithë tremujorit të tretë, parashikim ky i mbështetur në pritjet për daljen sezonale të *cash-it*, gjatë kësaj periudhe, u

realizuan edhe katër ndërhyrje me marrëveshje riblerjeje, me afat maturimi më të gjatë se një javë. Kështu u injektuan respektivisht 5.00 miliardë lekë, nëpërmjet *marrëveshjeve të anasjellta me maturim tremujor* dhe 3 miliardë lekë¹, nëpërmjet *marrëveshjeve të anasjellta me maturim njëmujor*.

Për tërheqjen e tepërisë së përkohshme të likuiditetit, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e *marrëveshjes së riblerjes me maturim njëjavor*, vetëm në një rast.

¹ Ndërhyrja me instrumentin njëmujor u bë 2 herë, duke ripërsëritur ndërhyrjen në maturim të ndërhyrjes së parë.

Gjatë muajit gusht u realizua dhe blerja me të drejta të plota e bonove të thesarit në vlerën nominale 1.50 miliardë lekë, blerje e cila kishte për qëllim mbajtjen konstante të portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë.


1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2007, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 1.61 miliardë lekë, në nivel të përafërt me tremujorin e kaluar (1.78 miliardë lekë).

Në kushtet e plotësimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal gjatë këtij tremujori, rreth 0.02 miliardë lekë në 2 raste përdorimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, gjatë tre tremujorëve të vitit 2007.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tre tremujorëve të vitit 2007.




2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në pjesën e parë të tremujorit të tretë të këtij viti, në tregun e brendshëm valutor u vunë re presione forcuese të monedhës vendase. Këto presione qenë kryesisht pasojë e prurjeve të ofertës sezonale të emigrantëve. Për të shmangur çrregullimet në treg, që mund të vinin si pasojë e ofertës së lartë të valutës, Banka e Shqipërisë që e pranishme në tregun e brendshëm valutor në kahun e

blerjes së valutës nga bankat e nivelit të dytë. Blerjet e Bankës së Shqipërisë kanë qenë të përqendruara në gjysmën e parë të tremujorit. Si rrjedhojë e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe, u shitën rreth 3.29 miliardë lekë.

Grafik 2: Ecuria e eur/lek dhe usd/lek gjatë periudhës korrik-shtator 2007.



2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës përcaktohen nga detyrimi i Qeverisë Shqiptare për shlyerjen e kësteve të borxhit të jashtëm, ku pagesat e kryera gjatë tremujorit të tretë llogariten në 867.10 milionë lekë.

Shuma e blerjeve nga Ministria e Financave për tremujorin e tretë të vitit është 1,576.78 milionë lekë, ndërsa shuma e blerjeve të valutës nga institucionet e huaja është 84.44 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).

Tabelë 2: Veprimet valutore të Bankës së Shqipërisë me institucione të tjera jobanka.

Institucioni financiar	Blerje të valutës	Shitje të valutës
MINISTRIA E FINANCAVE	1,576.78	867.10
TË TJERA (IDA, IBRD)	84.44	-